❖ Procedura e shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare

Pas depozitimit të iniciativës qytetare:

I. *administrata e bashkisë/këshilli bashkiak kryen verifikimin administrativ dhe ligjor të dokumentacionit;*

II. *iniciativa kalon për shqyrtim në komisionet përkatëse të këshillit bashkiak;*

III. *më pas paraqitet për diskutim dhe vendimmarrje në mbledhjen e këshillit bashkiak;*

IV. *këshilli bashkiak vendos për:*

a. *miratimin e iniciativës;*

b. *miratimin me ndryshime;*

c. *ose mosmiratimin e saj, duke argumentuar vendimin.*

Shqyrtimi bëhet në përputhje me procedurat e parashikuara në rregulloren e funksionimit të këshillit bashkiak dhe legjislacionin për vetëqeverisjen vendore.

Baza ligjore:

a) Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 20;
b) Ligji nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik".